
From: Arlind Imeri <info@gazetaexpose.com>
Sent: Thursday, February 27, 2025 12:54 PM
To: Era Pireva
Subject: Kërkesë për qasje në dokumente publike

Të nderuar,

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike, ju drejtohem me këtë kërkesë për të marrë informacion lidhur me cilësinë e ujit të ambalazhuar që gjendet në tregun e Kosovës. Konkretisht, kërkoj nga institucioni juaj të më vërë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Listën e operatorëve ekonomikë që ambalazhojnë ujë dhe që janë testuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, si dhe rezultatet e testeve të cilësisë së ujit për secilin prej tyre.
2. Rezultatet e testeve të kryera, nëse ka pasur të tilla, për ujin e ambalazhuar me emrin tregtar "MOKNE", përfshirë të dhënat mbi përbërjen kimike, mikrobiologjike dhe çdo element tjetër të vlerësuar nga Instituti juaj.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë të drejtën e qasjes në informacion publik, ju lutem që dokumentet e kërkuara të më dërgohen në formë elektronike ose në një format tjetër të përshtatshëm.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe pres përgjigjen tuaj brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Me respekt,

I nderuar,

Në lidhje me pyetjen tuaj, dëshirojmë të sqarojmë se në dokumentin që kemi dorëzuar në Agjencinë për Privatësi dhe Qasje në Dokumente Publike, rezultatet e kontrollave të prodhuesve, të cilët në mënyrë vullnetare vijnë për të kontrolluar produktet e tyre, nuk përfshihen në kategorinë e dokumenteve publike.

Arsyeja është se këto kontrolle të kualitetit kryhen me iniciativën dhe financimin e vetë prodhuesve, prandaj, ata janë pronarë të rezultateve të analizave, dhe se si laborator i akredituar, Qendra e Laboratorëve Testuese e IKSHPK-së është e obliguar të ruajë konfidencialitetin e informatave.

Sa i përket klientëve me kontratë, në çdo kontratë theksohet qartë:

Neni 4 - Konfidencialiteti:

“Konfidencialiteti i informatave është i garantuar sipas dokumenteve të akreditimit të QLT-së IKSHPK.”

Me ligjet në fuqi, prodhuesit kanë të drejtë të zgjedhin të bëjnë kontrollin e kualitetit të prodhimit në cilindo laborator të akredituar për produktet e tyre.

Inspektorati Sanitar i Kosovës e ka të përfshirë në planin vjetor të punës edhe kontrollimin e prodhuesve të ujit të ambalazhuar.

Ne, si IKSHPK, nuk kemi të drejtë të hyjmë në ambientet e prodhuesve për të marrë mostra pa lejen e tyre, pasi kjo është e drejtë ekskluzive e Inspektoratit Sanitar të Kosovës.

Aktualisht, IKSHPK ka kontrata me këta prodhues të ujit të ambalazhuar:

1. **Birra Peja** – Aquavita
2. **Mokne Group** – Mokna
3. **Ujë Rugove** – Rugove
4. **Water Group Kosova** – Crystal
5. **Tana** – Tana

Aktualisht, nuk kemi evidentuar asnjë problem me kualitetin e ujërave të ambalazuara që janë kontrolluar në laboratorët tanë. Në rast të ndonjë problemi, do të njoftohet menjëherë Inspektorati Sanitar.

Me respekt,

Era Pireva

Zyrtare për Informim

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës